

## V E N D I M

Nr.723, datë 19.11.1998

Në zbatim të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, ndryshuar me ligjin nr.8052, datë 21.12.1995, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

## V E N D O S I:

1. Përfitojnë rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikanteve, invalidët që kanë mjete motorike për invalidë.
  2. E drejta e invalidëve për të përfituar rimbursimin e shpenzimeve, për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikanteve, përcaktohet nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe organeve rajonale në varësi të tij, sipas kriterëve të përcaktuara nga ky Institut.
  3. Shuma mujore e rimbursimit të shpenzimeve për blerjen e karburanteve e të lubrifikanteve është 2 200 lekë.
  4. Pagesa e shumave mujore të rimbursimit të shpenzimeve për blerjen e karburanteve e të lubrifikanteve, të realizohen çdo muaj nga zyrat e sigurimeve shoqërore në rrethe, me paraqitjen e librezës së invaliditetit dhe të vërtetimit të posaçëm, të lëshuar nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë.
  5. Efektet financiare, në masën 8 300 000 (tetë milionë e treqind mijë) lekë në vit, për zbatimin e këtij vendimi, të përballohen nga Buxheti i Shtetit dhe të programohen çdo vit në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
  6. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.
  7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.48, datë 14.2.1994 “Për çmimet e shitjes së karburanteve për invalidët paraplegjikë”, shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.1999.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko